



Dokument informues

SG/Inf(2020)11

7 prill 2020

Rrespektimi i demokracisë, sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut në kornizën e krizës sanitare COVID-19

Udhëzues për shtetet anëtare

Hyrje

Qëllimi i këtij dokumenti është që t'u sigurojë qeverive një udhëzues për t'u marrë me krizën sanitare të paparë dhe në masë të gjerë, në mënyrë që të respektojnë vlerat themelore të demokracisë, sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut.

Tashmë është e ditur që qeveritë po përballen me sfida të mëdha në përpjekjen për të mbrojtur popullsitë e tyre nga kërcënimi i COVID-19. Kuptohet gjithashtu që funksionimi i rregullt i shoqërisë nuk mund të mbahet, veçanërisht në dritën e masës mbrojtëse kryesore që kërkohet për ta luftuar virusin, gjegjësisht izolimin. Është megjithatë e pranueshme që masat e ndërmarra në mënyrë të pashmangshme do të shkelin të drejtat dhe liritë të cilat janë pjesë përbërëse dhe e domosdoshme e shoqërive demokratike të qeverisura nga sundimi i ligjit.

Sfida kryesore sociale, politike dhe juridike me të cilën përballen shtetet tona anëtare do të jetë aftësia e tyre për t'iu përgjigjur kësaj krize në mënyrë efektive, ndërsa sigurimi që masat që ata marrin nuk dëmtojnë interesin tonë të mirëfilltë afatgjatë për t'i mbrojtur vlerat themelore të Evropës për demokracinë, sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut. Është pikërisht këtu që Këshilli i Evropës duhet të kryejë mandatin e tij thelbësor, përmes organeve të tij statutore dhe të gjithë organeve dhe mekanizmave të tij kompetent, të ofrojë forumin për t'u siguruar kolektivisht që këto masa të mbeten proporcionale me kërcënimin që paraqet përhapja e virusit dhe të jenë të kufizuara në kohë. Virusi po shkatërron shumë jetë dhe shumëçka tjetër që është shumë e dashur për ne. Ne nuk duhet ta lejojmë që t'i shkatërronjë vlerat tona themelore dhe shoqëritë e lira.

1. Derogimi në kohën e emergjencës (neni 15 Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut)

Shkalla e masave të marra në përgjigje të kërcënimit aktual COVID-19 dhe mënyra e zbatimit të tyre ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga një shtet në tjetrin në pika të ndryshme kohore. Ndërsa disa masa kufizuese të miratuara nga shtetet anëtare mund të justifikohen në bazë të dispozitave të zakonshme të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Konventa) në lidhje me mbrojtjen e shëndetit (shih nenin 5 paragrafi 1e, paragrafi 2 i neneve 8 deri 11 të Konventës dhe neni 2 paragrafi 3 i Protokollit Nr. 4 të Konventës), masat me natyrë të jashtëzakonshme mund të kërkojnë derogime nga detyrimet e shteteve sipas Konventës. Është përgjegjësi e secilit shtet të vlerësojë nëse masat që ai miraton lejojnë një derogim të tillë, në varësi të natyrës dhe shtrirjes së kufizimeve të zbatuara për të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Konventa. Mundësia që shtetet ta bëjnë këtë është një karakteristikë e rëndësishme e sistemit, duke lejuar zbatimin e vazhdueshëm të Konventës dhe të makinerisë së saj mbikëqyrëse edhe në kohërat më kritike.¹

Çdo derogim do të vlerësohet nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Gjykata) në rastet që do të paraqiten para saj². Gjykata u ka lejuar shteteve një margjinë të madhe vlerësimi në këtë fushë: *"Ai bie në radhë të parë për secilin shtet kontraktues, me përgjegjësinë e tij për 'jetën e kombit [të tij]', për të përcaktuar nëse kjo jetë kërcënohet nga një 'emergjencë publike' dhe nëse po, deri ku është e nevojshme të shkohet në përpjekje për ta kapërcyer emergjencën. Për shkak të kontaktit të tyre të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshëm me nevojat e ngutshme të momentit, autoritetet kombëtare janë në parim në një pozitë më të mirë se gjykatësi ndërkombëtar për të vendosur si për praninë e një emergjence të tillë, ashtu edhe për natyrën dhe fushëveprimin e derogimeve të nevojshme për të shmang atë. Në këtë çështje, neni 15 § 1 (...) u jep këtyre autoriteteve një margjinë të gjerë vlerësimi."*³

Një derogim gjithashtu u nënshtrohet kërkesave zyrtare: Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës, duke qenë depozituesi i Konventës, duhet të jetë plotësisht i informuar për masat e marra, për arsyet, pra, dhe për momentin kur këto masa kanë pushuar së vepruari (<https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/webContent/62111354>).

Disa të drejta të konventës nuk lejojnë asnjë derogim: e drejta e jetës, përveç në kontekstin e akteve të ligjshme të luftës (neni 2), ndalimi i torturës dhe trajtimi ose dënimi çnjerëzor ose degradues (neni 3), ndalimi i skllavërisë dhe servilizimit (neni 4§1) dhe rregulli i "pa ndëshkimit pa ligj" (neni 7).

¹ Përgjigjja e KM-së në rekomandimin e APKE-së 2125 (2018).

² Shih Udhëzimin për nenin 15 të Konventës (31 dhjetor 2019) të botuar nga Regjistri i Gjykatës.

³ *Irlandë k. MB* Aktgjykim i datës 18.01.1978, Seria A Nr. 25, paragrafi 207.

Nuk mund të ketë asnjë derogim nga heqja e dënimit me vdekje ose e drejta për të mos u gjykuar ose ndëshkuar dy herë (Protokollet Nr. 6 dhe 13 si dhe neni 4 i Protokollit Nr. 7).

Një derogim sipas nenit 15 nuk varet nga miratimi zyrtar i gjendjes së jashtëzakonshme ose të ndonjë regjimi të ngjashëm në nivelin kombëtar. Në të njëjtën kohë, çdo derogim duhet ta ketë një bazë të qartë në ligjin vendor për të mbrojtur kundër arbitraritetit dhe duhet të jetë rreptësisht i nevojshëm për të luftuar ndaj emergjencës publike. Shtetet duhet ta kenë parasysh se çdo masë e ndërmarrë duhet të përqipet të mbrojtë rendin demokratik nga kërcënimet ndaj tij, dhe çdo përpjekje duhet të bëhet për të mbrojtur vlerat e një shoqërie demokratike, siç është pluralizmi, toleranca dhe mendja e hapur⁴. Përderisa derogimet janë pranuar nga Gjykata për të justifikuar disa përjashtime nga standardet e Konventës, ato kurrë nuk mund të justifikojnë asnjë veprim që shkon në kundërshtim me kërkesat parësore të Konventës për ligjshmëri dhe proporcionalitet.

2. Respektimi i sundimit të ligjit dhe parimeve demokratike në kohë emergjente

2.1. Parimi i legalitetit

Edhe në një situatë emergjente sundimi i ligjit duhet të mbizotërojë.⁵ Është parim themelor i sundimit të ligjit që veprimi i shtetit duhet të jetë në përputhje me ligjin.⁶ "Ligji" në këtë kontekst përfshin jo vetëm aktet e Parlamentit, por edhe, për shembull, dekretet e ekzekutivit për situatë emergjente, me kusht që ato të kenë një bazë kushtetuese. Shumë kushtetuta parashohin një sistem të veçantë ligjor (ose sisteme) që rrisin kompetencat e autoriteteve ekzekutive në rast të një lufte ose një fatkeqësie të madhe natyrore ose një katastrofë tjetër⁷. Është gjithashtu e mundur që legjislatura të miratojë ligje për situatë emergjente të hartuara posaçërisht për trajtimin e krizës aktuale, të cilat i tejkalojnë rregullat ligjore tashmë ekzistuese. Çdo legjislacion i ri i këtij lloji duhet të jetë në përputhje me kushtetutën dhe standardet ndërkombëtare dhe, kur është e aplikueshme, t'i nënshtrohet shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese. Nëse parlamenti dëshiron të autorizojë qeverinë të devijojë nga legjislacioni i shumicës së posaçme (ose legjislacioni i miratuar pas një procedure tjetër të posaçme), kjo duhet të bëhet nga shumica e kërkuar për miratimin e legjislacionit, ose duke ndjekur të njëjtën procedurë të posaçme.

2.2. Kohëzgjatja e kufizuar e gjendjes së jashtëzakonshme dhe e masave emergjente

Gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, qeveritë mund të marrin një kompetencë të përgjithshme për të nxjerrë dekrete që kanë fuqinë e ligjit. Kjo është e pranueshme, me kusht që ato kompetenca të përgjithshme të kenë një kohëzgjatje të kufizuar. Qëllimi kryesor i regjimit të gjendjes së jashtëzakonshme (ose të ngjashme) është që të përmbajë zhvillimin e krizës dhe kthimin, sa më shpejt të jetë e mundur, në normalitet.⁸ Zgjatja e regjimit të gjendjes së jashtëzakonshme duhet t'i nënshtrohet kontrollit të domosdoshmërisë së tij nga parlamenti. Një përjetësim i pacaktuar i kompetencave të përgjithshme të jashtëzakonshme të ekzekutivit është i palejueshëm⁹.

Gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, jo vetëm që kompetenca e qeverisë për të vendosur ligje të kufizohet me kohëzgjatjen e gjendjes së jashtëzakonshme, por çdo legjislacion i miratuar gjatë gjendjes së jashtëzakonshme duhet të përfshijë gjithashtu kufizime të qarta kohore për kohëzgjatjen e këtyre masave të jashtëzakonshme (si një "sunset clause" që nënkupton afatin kur këto masa duhet të përfundojnë). Në të vërtetë, pas përfundimit të situatës emergjente mund të justifikohet të vazhdojë së aplikuara disa masa specifike, të synuara, por një zgjatje e tillë do të binte në kompetencën e parlamentit përmes procedurave të zakonshme.¹⁰

⁴ Mehmet Hasan Altan k. Turqisë, §§ 94 dhe 210; dhe Şahin Alpay k. Turqisë, §§ 78 dhe 180.

⁵ Shih Komisionin e Venecias, Opinioni mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut në situata emergjente, CDL-AD (2006)015, paragraf 13.

⁶ Shih Listën e Kontrollit të Komisionit të Venecisë për Sundimin e Ligjit (CDL-AD(2016)007), paragrafët 44 dhe 45.

⁷ Deri më 29 Mars 2020, 22 nga shtetet tona anëtare kanë deklaruar gjendjen e jashtëzakonshme.

⁸ Përvoja tregon se "sa më gjatë të zgjasë regjimi i emergjencës, aq më shumë shteti ka të ngjarë të largohet nga kriteret objektive që mund të kenë vërtetuar përdorimin e kompetencave emergjente në radhë të parë. Sa më gjatë të vazhdojë situata, aq më pak justifikim ka për trajtimin e një situatë si të jashtëzakonshme në natyrë me pasojë që ajo nuk mund të adresohet me përdorimin e mjeteve normale juridike." - Komisioni i Venecias, Turqi - Opinioni mbi Ligjet e Dekretit të Emergjencës Nr. 667-676 të miratuara pas grushtit të dështuar të shtetit të 15 korrikut 2016, CDL-AD(2016)037, paragraf 41

⁹ CommDH(2002)7, Opinioni 1/2002 për disa aspekte të derogimit të Mbretërisë së Bashkuar nga neni 5 paragraf 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, f. 25; shih edhe Komisionin e Venecias, Parametrat mbi marrëdhëniet midis shumicës parlamentare dhe opozitës në një demokraci: Një listë kontrolli (CDL-AD(2019)019), paragraf 119.

¹⁰ Shih Rezolutën e APKE-së 1659 (2009), Mbrojtja e të drejtave të njeriut në situata emergjente, f. 12; Shih edhe Listën e Kontrollit të Sundimit të Ligjit, të cituar më lart, dhe nenin 15 të Konventës ("Derogimi në kohë emergjente"); Neni 4 i ICCPR; Neni 27 i GJEDNJ-së. Për kompetencat

2.3. **Fushëveprimi i kufizuar i legjislacionit të emergjencës; parimi i domosdoshmërisë**

Parimi i domosdoshmërisë kërkon që masat emergjente të jenë në gjendje të arrijnë qëllimin e tyre me ndryshimin minimal të rregullave dhe procedurave normale të vendimmarrjes demokratike¹¹. Prandaj, kompetenca e qeverisë për të nxjerrë dekrete të emergjencës nuk duhet të rezultojë në një *carte blanche* ("carte blanche" nënkupton dhënien e lirisë totale për të vepruar ose fuqi e plotë diskrecionale) të dhënë nga ligjvënësi për ekzekutivin. Duke pasur parasysh zhvillimin e shpejtë dhe të paparashikueshëm të krizës, delegacione relativisht të mëdha legjislative mund të jenë të nevojshme, por duhet të formulohen sa më ngushtë që të jetë e mundur në rrethana, në mënyrë që të zvogëlohet çdo potencial për abuzim¹². Si rregull i përgjithshëm, reformat themelore ligjore duhet të vihen në lëvizje gjatë gjendjes së jashtëzakonshme¹³.

2.4. **Shpërndarja e kompetencave dhe kontrollet mbi veprimet ekzekutive gjatë gjendjes së jashtëzakonshme**

Autoritetet ekzekutive duhet të jenë në gjendje të veprojnë shpejt dhe me efikasitet. Kjo mund të kërkojë miratimin e procedurave më të thjeshta të vendimmarrjes dhe lehtësimin e disa mekanizmave kontrollues "checks and balances" Kjo gjithashtu mund të përfshijë, në masën e lejuar nga kushtetuta, duke anashkaluar ndarjen standarde të kompetencave midis autoriteteve lokale, rajonale dhe qendrore në lidhje me disa fusha specifike, të kufizuara, për të siguruar një përgjigje më të koordinuar ndaj krizës dhe me mirëkuptimin që të drejtat e plota të autoriteteve lokale dhe rajonale të rivendosen sa më shpejt që situata ta mundësojë atë.

Parlamentet, megjithatë, duhet të mbajnë kompetencën për ta kontrolluar veprimin e ekzekutiv¹⁴ në veçanti duke verifikuar, në intervale të arsyeshme, nëse kompetencat emergjente të ekzekutivit janë akoma të justifikuara, ose duke ndërhyrë në baza *ad hoc* për t'i modifikuar ose anuluar vendimet e ekzekutivit.¹⁵ Shpërndarja e parlamenteve gjatë gjendjeve të jashtëzakonshme nuk duhet të jetë e mundur, dhe me të vërtetë sipas shumë kushtetutave mandati i parlamentit zgjatet deri në fund të gjendjes së jashtëzakonshme.

Funksioni thelbësor i gjyqësorit - veçanërisht gjykatat kushtetuese, ku ato ekzistojnë - duhet të ruhet. Është e rëndësishme që gjyqtarët të shqyrtojnë kufizimet më serioze të të drejtave të njeriut të paraqitura nga legjislacioni i emergjencës. Shtyrjet, "përshpejtimi" ose trajtimi në grup i disa kategorive të rasteve mund të lejohen, dhe autorizimi paraprak gjyqësor në disa raste mund të zëvendësohet me shqyrtim gjyqësor "ex post" (shih edhe më poshtë, kapitulli 3.2).

Gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, mbajtja e zgjedhjeve dhe referendumeve mund të jetë problematike, pasi mundësia e fushatës është jashtëzakonisht e kufizuar në kohë krize.

e emergjencës shih edhe raportet nga Komisioni i Venecias për Kompetencat e Emergjencës (CDL-STD(1995)012) dhe për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në situata emergjente (CDL-AD(2006)015).

¹¹ Parimi i domosdoshmërisë nuk përmendet drejtpërdrejt në kontekstin e masave institucionale të emergjencës, por mund të vijë nga kërkesa e proporcionalitetit dhe domosdoshmërisë së masave emergjente në fushën e të drejtave të njeriut - shih Komisionin e Venecias, Opinioni mbi Projektligjin kushtetues për "Mbrojtjen e Kombit" të Francës, CDL-AD(2016)006, parag. 71

¹² CM(2008)170, Dokumenti i Komitetit të Ministrave për Këshillin e Evropës dhe Sundimin e Ligjit, f. 46; shih edhe Komisionin e Venecias, Parametrat e Marrëdhënieve midis shumicës parlamentare dhe opozitës në një demokraci: Një listë kontrolli (CDL-AD(2019)019), paragrafë 119 - 121, dhe Turqia - Opinioni mbi Ligjet e Dekretit të Emergjencës Nr. 667-676 të miratuara pas grushtit të dështuar të shtetit të 15 korrikut 2016 (CDL-AD(2016)037), parag. 98.

¹³ Një numër i konsiderueshëm i kushtetutave evropiane kanë dispozita që ndalojnë ndryshimet kushtetuese në kohë lufte, emergjente ose situata të ngjashme. Shih edhe Komisionin e Venecias, Turqi - Opinioni mbi Ligjet e Dekretit të Emergjencës Nr. 667-676 të miratuara pas grushtit të dështuar të shtetit të 15 korrikut 2016, CDL-AD(2016)037, parag. 80 dhe 90).

¹⁴ Shih Rekomandimin e APKE-së 1713 (2005), Mbikëqyrja Demokratike e sektorit të sigurisë në shtetet anëtare, f. 38.

¹⁵ Lista e Kontrollit e Komisionit të Venecisë për Sundimin e Ligjit (CDL-AD(2016)007), parag. 51.

3. Standardet përkatëse të të drejtave të njeriut

3.1. *E drejta për jetë (neni 2 i Konventës) dhe Ndalimi i torturës, trajtimi apo dënimi çnjerëzor ose degradues (neni 3 i Konventës); e drejta e qasjes në kujdesin shëndetësor (neni 11 i Kartës së rishikuar Sociale Evropiane)*

E drejta për jetë dhe ndalimi i torturës, trajtimi ose dënimi çnjerëzor ose degradues i përkasin të drejtave thelbësore të Konventës pasi ato nuk mund të jenë subjekt i ndonjë derogimi, madje edhe në kohën e emergjencës publike siç është COVID-19.

Ato janë mbajtur vazhdimisht për të kërkuar detyrime pozitive për të mbrojtur njerëzit në kujdesin shtetëror nga sëmundjet vdekjeprurëse dhe vuajtjet pasuese¹⁶.

Konventa vazhdimisht kërkon që çdo shtet anëtar të sigurojë një nivel adekuat të kujdesit mjekësor për njerëzit e privuar nga liria¹⁷. Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT) nxori një [Deklaratë Parimesh në lidhje me trajtimin e personave të privuar nga liria në kontekstin e pandemisë COVID-19](#). Ato aplikohen në vende të ndryshme, duke përfshirë ambientet e paraburgimit policor, burxhet, qendrat e ndalimit të imigracionit, spitalet psikiatrike dhe shtëpitë e kujdesit shoqëror, si dhe në objektet apo zonat e ndryshme të sapo hapura, ku personat vendosen në karantinë në kontekstin e pandemisë COVID-19. Parimet e KPT-së i referohen gjithashtu nevojës për të mbrojtur personelin që punon në këto institucione dhe për të siguruar qasje të vazhdueshme nga organet e pavarura kombëtare të monitorimit në institucionet e paraburgimit. Komisioneri për të Drejtat e Njeriut publikoi gjithashtu një [Deklaratë: Pandemia e COVID19: duhen hapa urgjentë për të mbrojtur të drejtat e të burgosurve në Evropë](#).

Përtej njerëzve në kujdesin e shteteve, përgjegjësia sipas neneve 2 dhe 3 të Konventës mund të referohet në lidhje me pacientët me sëmundje të rëndë, personat me aftësi të kufizuara ose personat e moshuar (shih [Rekomandimin CM/Rec\(2014\)2](#) për promovimin e të drejtave të njeriut, personat e moshuar dhe Deklaratat e Komisionerit për të Drejtat e Njeriut për personat me aftësi të kufizuara dhe personat e moshuar gjatë pandemisë COVID-19¹⁸). Ekspozimi i tyre ndaj sëmundjes dhe niveli ekstrem i vuajtjes mund të konsiderohet i papajtueshëm me detyrimet pozitive të shtetit për ta mbrojtur jetën dhe parandaluar keqtrajtimin. Ky detyrim pozitiv konfirmohet më tej nga neni 11 i Kartës Sociale Evropiane (i rishikuar), sipas të cilit shtetet palë duhet të demonstrojnë aftësinë e tyre për të përballuar sëmundjet infektive, me anë të marrëveshjeve për raportimin dhe njoftimin e sëmundjeve dhe duke ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme emergjente në rast të epidemive.¹⁹ Vëmendja e shtuar e shteteve ndaj grupeve të cënueshme do të ishte në përputhje me të drejtën e njerëzve për qasje të barabartë në kujdes shëndetësor (neni 3 i [Konventës për të Drejtat e Njeriut dhe Biomjekësi](#), "Konventa Oviedo").

Në këtë drejtim kujtohet se disponueshmëria dhe qasja e pacientëve ndaj ilaçeve cilësore është më e rëndësishme se kurrë në kontekstin e pandemisë aktuale COVID-19. Konventa e Këshillit të Evropës për Përpunimin e Farmakopesë²⁰ Evropiane synon të sigurojë një bazë ligjore dhe shkencore për të siguruar cilësinë e ilaçeve dhe përbërësve të tyre në formën e një punimi të vetëm referencë, Farmakopea Evropiane. Nën kujdesin e Komisionit Evropian të Farmakopesë, 39 shtete anëtare dhe Bashkimi Evropian, së bashku me ekspertë nga 29 vëzhgues, përfshirë Organizatën Botërore të Shëndetësisë, i bashkojnë forcat dhe ndajnë punën për të vendosur standarde të cilësisë, të cilat janë të zbatueshme në të gjitha shtetet nënshkruese dhe zbatohen në më shumë se 120 shtete në të gjithë botën.

¹⁶ Shih fletën e fakteve "Të drejtat lidhur me shëndetin e të burgosurve" botuar nga Regjistri i Gjykatës.

¹⁷ Shih *Khudobin k. Rusicë*, nr. 59896/00, 26 tetor 2006; Ndërsa KPT detajoi në Deklaratën e tij të parimeve që kanë të bëjnë me trajtimin e personave të privuar nga liria në kontekstin e sëmundjes nga koronavirusi (pandemia COVID-19), "një nivel joadekuat i kujdesit shëndetësor mund të çojë me shpejtësi në situata që përfshihen në fushën e termit "trajtim çnjerëzor dhe degradues".

¹⁸ Komisioneri për të Drejtat e Njeriut, i cili në punën e tij shpesh thekson se ambientet e mëdha të banimit ku personat privohen nga liria janë të papërshtatshme për personat me aftësi të kufizuara dhe personat e moshuar, u bëri thirrje shteteve anëtare që përballen me pandeminë të ndalojnë pranimet e reja në institucione të tilla, të zhvendosin personat me aftësi të kufizuara prej tyre sa më shumë që të jetë e mundur, dhe të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur banorët e mbetur; Deklaratat e Komisionerit: [Personat e moshuar kanë nevojë për mbështetje më shumë se kurrë në kohën e pandemisë COVID-19](#), 20 mars 2020, dhe Personat me aftësi të kufizuara nuk duhet të lihen pas në përgjigjen ndaj pandemisë COVID-19, 2 prill 2020.

¹⁹ KEDS, Konkluzione XVII-2 (2005), Letoni.

²⁰ Konventa e Këshillit të Evropës për Përpunimin e Farmakopesë Evropiane, ETS Nr. 050, Strasburg, 22 korrik 1964, dhe Protokollin e Konventës për Përpunimin e Farmakopesë Evropiane, ETS Nr. 134, Strasburg, 1 nëntor 1989

Më në fund, si nga Konventa ashtu edhe nga Karta Sociale Evropiane, shtetet kanë për detyrë të informojnë popullatën për rreziqet e njohura që lidhen me pandeminë dhe për sjelljet ose masat për të shmangur përhapjen e sëmundjes²¹.

3.2. E drejta për liri dhe siguri (neni 5) dhe e drejta për një gjykim të drejtë (neni 6)

Masat e pashembullta të ndërmarra në përgjigje ndaj COVID-19 mund të ndikojnë në aftësinë e shtetit për të garantuar të drejtën e lirisë dhe sigurisë dhe për të ndryshuar funksionimin e rregullt të sistemit gjyqësor.

Neni 5.1(e) specifikon që parandalimi i përhapjes së sëmundjeve infektive është një nga arsytet për të cilat një person mund të privohet nga liria e tij/saj. Para përdorimit të masave të tilla, shtetet pritet të kontrollojnë ekzistencën e një baze juridike përkatëse dhe të marrin në konsideratë nëse masat që lidhen me privimin e lirisë janë rreptësisht të domosdoshme kundër alternativave më pak të rrepta. Gjatësia e kufizimit të detyrueshëm dhe mënyra e zbatimit të tij në praktikë janë të rëndësishme në këtë kontekst.

Masat të cilat synojnë të adaptojnë modalitetet e qasjes në gjykata duhet të hartohen në atë mënyrë që të jetë në përputhje me nenin 6, jo vetëm në rastet kur kërkohet kujdes i veçantë procedural (proceset gjyqësore të cenueshme, kontestet familjare dhe të punës, etj.). Kujdestaria e zgjatur e policisë ose shqyrtimi gjyqësor i vonuar i privimit të lirisë mund të çojë në shkelje të nenit 5 të Konventës.

Padyshim që derogimet sipas nenit 15 mund të zgjerojnë gamën e masave të lejueshme sipas neneve 5 dhe 6 të Konventës dhe të zgjerojnë marginën e manovrës së autoriteteve shtetërore në përputhje me afatet e caktuara kohore dhe kërkesat e tjera të zakonshme procedurale. Sidoqoftë, ndalimi themelor i arrestimit pa bazë ligjore ose shqyrtim gjyqësor në kohë, dhe nevoja për t'u siguruar të arrestuarve masa themelore procedurale, të tilla si qasja te mjeku, avokati ose tek të afërmit, në parim duhet të respektohet në rrethanat aktuale. Shtetet gjithashtu mbesin nën një detyrim të përgjithshëm për të siguruar që gjykimet plotësojnë kërkesën themelore të drejtësisë (të tilla si principi i "equality of arms" (" që nënkupton një ekuilibër të barazisë midis mundësive që u ipen palëve të përfshira në çështje gjyqësore) dhe të respektojnë prezumimin e pafajësisë, dhe të sigurojnë që të mos merren hapa që do të rezultojnë në ndërhyrje në pavarësinë e gjyqtarëve ose të gjykatave.

3.3. E drejta për jetë private, liri të ndërgjegjes, liri të shprehjes, liri të bashkimit

Gëzimi efektiv i të gjitha këtyre të drejtave dhe lirive të garantuara nga nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Konventës është një pikë referimi për shoqëritë moderne demokratike. Kufizimet mbi to janë të lejueshme vetëm nëse ato përcaktohen me ligj dhe në proporcion me qëllimin legjitim të ndjekur, përfshirë mbrojtjen e shëndetit. Kufizimet domethënëse për aktivitetet e zakonshme shoqërore, duke përfshirë qasjen në vendet publike të kultit, tubimet publike dhe ceremonitë e dasmës dhe varrimit, mund të çojnë në mënyrë të pashmangshme në ankesa të diskutueshme sipas dispozitave të mësipërme. U takon autoriteteve të sigurojnë që çdo kufizim i tillë, pavarësisht nëse bazohet në një derogim ose jo, është përcaktuar qartë me ligj, në përputhje me garancitë kushtetuese përkatëse dhe në proporcion me qëllimin që ndjek²².

Ndërsa kufizimet e ngritura për të drejtat e lartpërmendura mund të jenë plotësisht të justifikuar në kohë krize, sanksionet e ashpra penale shkaktojnë shqetësim dhe duhet t'i nënshtrohen një kontrolli të rreptë. Situatat e jashtëzakonshme nuk duhet të çojnë në zmadhimin e mjeteve penale. Një ekuilibër i drejtë midis detyrimit dhe parandalimit është mënyra më e përshtatshme, nëse jo dhe mënyra e vetme, për t'i përmbushur kërkesat e proporcionalitetit të Konventës.

Liria e shprehjes dhe informacionit, liria e mediave, qasja në informacionin zyrtar

²¹ Shih Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, *Guerra dhe të tjerët k. Italisë*, aktgjykimi i 19 shkurt 1998, *Raportet e aktgjyqimeve dhe vendimeve* 1998-I, f. 227, § 58 ; *Öneryıldız k. Turqisë* [GC], nr. 48939/99, 30 nëntor 2004.

²² Shih *Mehmet Hasan Altan k. Turqisë*, 13237/17, 20 mars 2018; sa i përket lirisë së tubimit, shih *Lashmankin dhe të tjerët k. Rusisë*, nr. 57818/09, 7 shkurt 2017, në paragraf. 434; në këtë rast Gjykata vendosi që një ndërhyrje e përgjithshme në demonstrim është e pranueshme nëse ekziston rreziku i vërtetë i këtyre që rezultojnë në çrregullim i cili nuk mund të parandalohet me masa të tjera, më pak të rrepta dhe nëse disavantazhi i ndikimit të ndalimit në demonstrime është tejkaluar qartë nga konsideratat e sigurisë të thirrura për ta justifikuar atë.

Liria e shprehjes, përfshirë rrjedhën e lirë dhe në kohë të informacionit, është një faktor kritik për aftësinë e mediave për të raportuar për çështje që lidhen me pandeminë. Media dhe gazetarët profesionistë, veçanërisht transmetuesit publik, kanë një rol kryesor dhe përgjegjësi të veçantë për ofrimin e informacionit në kohë, të saktë dhe të besueshëm për publikun, por edhe për parandalimin e panikut dhe nxitjen e bashkëpunimit të njerëzve. Ata duhet t'i përmbahen standardeve më të larta profesionale dhe etike të gazetarisë së përgjegjshme, dhe kështu të përcjellin mesazhe autoritative në lidhje me krizën dhe të përmbahen nga botimi ose amplifikimi i tregimeve të paverifikuara, e lëre më materiale të paqarta ose sensacionale. Rrethanat e jashtëzakonshme mund t'i detyrojnë gazetarët përgjegjës të përmbahen nga zbulimi i informacionit të mbajtur nga qeveria, i destinuar për përdorim të kufizuar - siç është, për shembull, informacioni mbi masat e ardhshme për të zbatuar një politikë më të rreptë izolimi²³.

Qasja e publikut në informacionin zyrtar duhet të menaxhohet në bazë të parimeve ekzistuese të përcaktuara në praktikën gjyqësore të Gjykatës.²⁴ Çdo kufizim i qasjes në informacionin zyrtar duhet të jetë i jashtëzakonshëm dhe proporcional me qëllimin e mbrojtjes së shëndetit publik. [Konventa për Qasje në Dokumentet Zyrtare](#) ("Konventa Tromsø") nënvizon nevojën për transparencë dhe parasheh që, me iniciativë vetanake dhe kur është e përshtatshme, një autoritet publik të marrë masat e nevojshme për të bërë dokumente zyrtare publike për të inkurajuar pjesëmarrjen e informuar nga publiku për çështje me interes të përgjithshëm.

Në të njëjtën kohë, komunikimet zyrtare nuk mund të jenë kanali i vetëm informues në lidhje me pandeminë. Kjo do të çonte në censurë dhe shtypje të shqetësimeve legjitime. Gazetarët, media, profesionistët e mjekësisë, aktivistët e shoqërisë civile dhe publiku i gjerë duhet të jenë në gjendje të kritikojnë autoritetet dhe të shqyrtojnë reagimin e tyre ndaj krizës. Çdo kufizim paraprak për tema të caktuara, mbyllja e mediave ose bllokimi i drejtpërdrejtë i qasjes në platformat e komunikimit në internet kërkojnë një kontroll më të kujdesshëm dhe justifikohen vetëm në rrethanat më të jashtëzakonshme²⁵. Pandemia nuk duhet të përdoret për të heshtur sinjalizuesit (shih [Rekomandimin CM/Rec\(2014\)7](#) për mbrojtjen e sinjalizuesve),²⁶ ose kundërshtarët politikë.²⁷ Përhapja e dezinformatave mund të trajtohet me sanksione *ex post*, dhe me fushata qeveritare informacioni. Shtetet duhet të punojnë së bashku me platformat në internet dhe mediat për të parandaluar manipulimin e opinionit publik, si dhe për t'u dhënë një prioritet më të madh burimeve në përgjithësi të besuara të lajmeve dhe informacionit, dhe veçanërisht atyre që komunikohen nga autoritetet shëndetësore publike.

Privatësia dhe mbrojtja e të dhënave

Teknologjitë e reja të qasjes në - dhe përpunimi i - të dhënave personale kanë potencialin për të përmirësuar dhe korrigjuar pandeminë. Monitorimi, ndjekja dhe parashikimi janë hapa thelbësorë të një mbikëqyrjeje epidemike. Me shumëzimin dhe bollëkun e teknologjive dhe mjeteve dixhitale të sofistikuar në dispozicion (të dhënat e gjeolokimit, inteligjenca artificiale, njohja e fytyrës, aplikacionet e mediave sociale) mund të lehtësohet mbikëqyrja e tillë epidemike.

Në të njëjtën kohë, potenciali ndërhyrës i teknologjive moderne nuk duhet të lihet i pakontrolluar dhe i pabalancuar kundrejt nevojës së respektit për jetën private. Parimet e mbrojtjes së të dhënave dhe Konventa 108 e Këshillit të Evropës (dhe versioni i saj i modernizuar, i referuar si "Konventa 108+"²⁸) gjithmonë kanë lejuar një balancim të standardeve të larta mbrojtëse dhe interesave publike, përfshirë shëndetin publik. Konventa lejon përjashtime nga rregullat e zakonshme të mbrojtjes së të dhënave, për një periudhë të kufizuar kohore dhe me masa mbrojtëse të përshtatshme (p.sh. anonimizimi) dhe një kornizë efektive e mbikëqyrjes për të siguruar që këto të dhëna janë mbledhur, analizuar, ruajtur dhe ndarë në mënyra legjitime dhe të përgjegjshme. Përpunimi në shkallë të gjerë i të dhënave personale me anë të inteligjencës artificiale duhet të bëhet vetëm kur provat shkencore tregojnë bindshëm se përfitimet e mundshme të shëndetit publik i tejkalojnë përfitimet e zgjidhjeve alternative, më pak ndërhyrëse. Rrjeti i ekspertëve i Këshillit të Evropës për inteligjencën artificiale²⁹

²³ Shih Këshillin e Evropës [Udhëzuesi mbi mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe informacionit në kohë krize](#).

²⁴ Shih, për shembull, *Magyar Helsinki* [GC], paragrafët 156-170).

²⁵ *Cumpana Mazare* [GC], parag. 118.

²⁶ <https://www.bbc.com/news/world-asia-china-51403795>

²⁷ Shih Këshillin e Evropës [Udhëzuesi mbi mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe informacionit në kohë krize](#).

²⁸ Konventa e modernizuar për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale (CETS 223): https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016807c65bf

²⁹ Komisioni *ad hoc* për Inteligjencën Artificiale, CAHAI

dhe partnerët e tij mund të lehtësojnë shkëmbimin e njohurive në këtë drejtim.

3.4. Ndalimi i diskriminimit (neni 14 Konventa dhe neni 1, Protokollin Nr. 12, neni E i Kartës Sociale Evropiane) dhe standardet në lidhje me diversitetin dhe përfshirjen

Parimi i mosdiskriminimit është mjaft i rëndësishëm në kontekstin aktual. Gjatë vlerësimit nëse masat deroguese u "kërkuan rreptësisht" sipas nenit 15 të Konventës, Gjykata shqyrton nëse masat diskriminojnë në mënyrë të pajustificueshme midis kategorive të ndryshme të personave.³⁰ Gjithashtu, forma të caktuara të diskriminimit mund të rezultojnë në trajtim degradues të përshkruar nga neni 3, një dispozitë që nuk mund të derogohet.³¹

Për më tepër, fakti për të mos marrë parasysh nevojat specifike të personave që i përkasin një grupi të pafavorizuar mund të rezultojë në diskriminim.³² Ndalimi i diskriminimit në këtë mënyrë mund të sjellë detyrime për të ndërmarrë masa pozitive për të arritur barazi thelbësore.³³ Një qasje e ngjashme ndiqet nën Kartën Sociale Evropiane (neni E).³⁴ Në këtë kuptim, shumë prej dispozitave të Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Kartës Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Minoriteteve, por edhe Rekomandimet e Politikës së Përgjithshme të ECRI-së duhet të shihen si shprehje të parimeve të barazisë dhe mosdiskriminimit.

Masat e jashtëzakonshme të marra sot në kuadër të luftës kundër përhapjes së virusit ka të ngjarë të shtojnë pyetje për pasojat e tyre të mundshme diskriminuese. Për shembull, e drejta për arsim siç përcaktohet në Konventë (neni 2 i Protokollit Nr. 1) dhe Kartën Sociale Evropiane (neni 17) në parim duhet të sigurohet, edhe pse mënyrat në të cilat sigurohet kërkojnë adaptim. Sidoqoftë, duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë për të siguruar që anëtarët e grupeve të cenueshme vazhdojnë të përfitojnë nga e drejta për arsim dhe të kenë qasje të barabartë në mjete dhe materiale arsimore në kohën e mbylljes. Një studim i hollësishëm i vështirësive dhe rreziqeve me të cilat përballen romët, emigrantët, personat që i përkasin pakicave kombëtare dhe personat LGBTI, por edhe për praktikën e shkëlqyera të përfshirjes që janë miratuar tashmë gjatë kësaj krize në disa shtete anëtare, është në përgatitje.³⁵

4. Mbrojtja nga krimi; mbrojtja e viktimave të krimit

Incidente dhe prova raportohen gjithnjë e më shumë që tregojnë se politika e izolimit dhe mbylljes dërgon në rritjen e niveleve të dhunës në familje, seksuale dhe dhunës në baza gjinore - dhe për këtë arsye në një nevojë të shtuar të mbrojtjes kundër kësaj. Qasja e atyre shteteve anëtare që, në përputhje me frymën e Konventës³⁶ së Stambollit, janë në kërkim të mënyrave për të vazhduar ofrimin e shërbimeve që ofrojnë mbështetje dhe mbrojtje për viktimat e një dhune të tillë, të përshtatur me regjimin e izolimit, dukshëm do të mirëpritet. Këshilli i Evropës mund të shpërndajë informacion mbi praktikën e vendosura në shtetet e tij anëtare, të tilla si për shembull mundësimi i mënyrave alternative që viktimat t'i raportojnë incidentet e dhunës³⁷. Është gjithashtu e rëndësishme të merren parasysh mjete inovative në mënyrë që fëmijët të kenë qasje në linja ndihmëse dhe linja telefonike në dritë të dispozitave të Konventës Lanzarote të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual, në mënyrë që të raportojnë dhunën, keqtrajtimin dhe abuzimin seksual gjatë kësaj pandemie.³⁸

³⁰ GJEDNJ, *A. dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar* (GC), 3455/05, 19 shkurt 2009, §§ 182-190.

³¹ GJEDNJ, *Qipro k. Turqisë* (GC), 25781/94, 10 maj 2001, §§ 312-315.

³² Shih, p.sh., GJEDNJ, *Horvath dhe Kiss k. Hungarisë*, 11146/11, 29 janar 2013,.

³³ GJEDNJ, *Horvath dhe Kiss k. Hungarisë*, 11146/11, 29 janar 2013, § 116; GJEDNJ, *Çam k. Turqisë*, 51500/08, 23 shkurt 2016. Shih edhe Raportin Shpjegues të Protokollit Nr. 12 të Konventës.

³⁴ Për Komitetin Evropian të të Drejtave Sociale (KEDS), diskriminimi mund të rezultojë nga mosrespektimi i duhur dhe pozitiv i të gjitha dallimeve përkatëse midis personave në një situatë të krahasueshme, ose mos marrja e hapave të duhur për të siguruar që të drejtat dhe përparësitë kolektive që janë të hapura për të gjithë është vërtet e arritshme nga dhe për të gjithë. Shih, p.sh., KEDS, *Confederazione Generale Italiana del Lavoro (CGIL) k. Italisë*, Ankesa Nr. 91/2013, 12 tetor 2015, § 237; KEDS, *Confédération française démocratique du travail (CFDT) k. Francës*, Ankesa Nr. 50/2008, vendimi mbi meritat e 9 shtatorit 2009, §§ 39 dhe 41.

³⁵ Studimi po përgatitet nga Sekretariati i Komitetit të ri Drejtues për Anti-Diskriminimin, Diversitetin dhe Përfshirjen (CDADI), për shqyrtim në mbledhjen e parë të CDADI-së. Një shënim hyrës së shpejtë do të publikohet në uebsajtin e tij.

³⁶ Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, CETS Nr. 2010, Stamboll, 11 maj 2011: <https://www.coe.int/conventions/treaty/210>

³⁷ Shih Deklaratën e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës të 30 marsit 2020 (<https://www.coe.int/en/web/portal/-/covid-19-crisis-secretary-general-concerned-about-increased-risk-of-domestic-violence>) dhe Deklaratën e Presidentit të GREVIO e 24 marsit 2020: <https://rm.coe.int/grevio-statement-covid-24-march-2020/pdfa/16809cf55e>

³⁸ Deklarata e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të Komitetit të Lanzarote: <https://rm.coe.int/covid-19-lc-statement-en-final/16809e17ae>

Viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore mund të gjenden në një pozicion edhe më të cenusshëm, si rezultat i aftësive të kufizuara të zbatimit të ligjit dhe shërbimeve që i mbështesin ata, siç janë strehimoret.³⁹

Ndërsa shoqëritë moderne mbështeten më shumë se kurrë në sisteme kompjuterike, në kohë krizash akterët me qëllim të keq mund të shfrytëzojnë edhe më shumë këtë besim në avantazhin e tyre (skemat e mashtrimit, fushatat e *phishing* dhe shpërndarja e *malware* përmes faqeve të internetit në dukje origjinale të informacionit ose këshillave mbi COVID-19 përdoren për të infektuar kompjuterë, për të nxjerrë kredenciale të përdoruesve ose pagesa mashtruese). Fëmijët nuk bëjnë përjashtim nga rreziqet në hapësirën në internet dhe me mbylljen e shkollave, përdorimi i shtuar i internetit dhe mediave sociale ndikon në sigurinë e tyre. Për më tepër, shpërthimi i koronavirusit për fat të keq ka ofruar mundësi të reja për kriminelët që të përfitojnë nga rritja e kërkesës për produkte mjekësore, higjienike dhe të mbrojtjes personale. Këto përfshijnë ilaçe të rreme ose pajisje mjekësore të rreme, të tilla si pajisje testimi COVID-19, të cilat janë duke u vë në dispozicion si në internet ashtu edhe jashtë tij.

Prodhimi dhe shpërndarja e produkteve mjekësore të falsifikuara përbëjnë një rrezik të konsiderueshëm për shëndetin publik dhe rrezikojnë të drejtën për jetë dhe të drejtën për shëndet. Autoritetet e drejtësisë penale duhet të angazhohen në bashkëpunim të plotë për të zbuluar, hetuar, atribuar dhe ndjekur penalisht veprat e mësipërme. Në kuadër të Konventave të Këshillit të Evropës (Krimi Kibernetik (Budapest), Konventa⁴⁰ MEDICRIME, Konventa Lanzarote për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi) shtetet palë bashkëpunojnë ngushtë për t'i përmirësuar dispozitat e tyre të ligjit penal, kompetencat procedurale dhe bashkëpunimin ndërkombëtar të nevojshëm për t'iu kundërvënë këtyre kërcënimeve.

5. Hapat e ardhshëm: Këshilli i Evropës më i rëndësishëm se kurrë më parë

Këshilli i Evropës u krijua për të rindërtuar paqen e qëndrueshme në Evropë pas luftës më katastrofike që kishte njohur ndonjëherë. Ai ka arritur sukses gjatë gjithë historisë së saj 70-vjeçare, kryesisht duke u bërë një organizatë pan-evropiane me institucione unike që japin një shembull udhëheqës botëror. Sfida që përballen shoqëritë tona sot është e pashembullt. Edhe pas fazës akute të krizës, shoqëritë tona do të duhet të gjejnë mënyrat për të riparuar dëmet sociale dhe ekonomike dhe për të rritur më tej besimin në institucionet tona demokratike. Ndër të tjera, do të duhet të fillohet një reflektim i gjerë mbi mbrojtjen e individëve dhe grupeve më të cenusshëm në shoqëritë tona dhe për mjetet për të mbrojtur të drejtat e tyre në një model qeverisjeje më të qëndrueshëm dhe solidar.

Këshilli i Evropës do të vazhdojë të bëjë çdo përpjekje për të ndihmuar shtetet anëtare gjatë krizës aktuale dhe pasojave të saj. Gama e gjerë e instrumenteve të tij juridike efektive, ekspertiza teknike dhe rrjetet e gjera të ekspertëve ofrojnë mjete të vlefshme për qeveritë dhe qytetarët për të gjetur përgjigjet më të mira dhe më të qëndrueshme për të mbrojtur shëndetin publik, për të ruajtur strukturën demokratike të shoqërive tona dhe për të lehtësuar pasojat sociale të krizës.

Organet statore, të gjitha institucionet e Këshillit të Evropës dhe Sekretariati janë mobilizuar dhe nuk do të kursejnë asnjë përpjekje për t'i përdorur mjetet dhe burimet e Organizatës për të ndarë informacione, praktika të mira dhe mësim të marra mes të gjitha palëve të interesuara, përfshirë autoritetet, shoqërinë civile dhe qytetarët, në mënyrë që të gjejnë përgjigje të përbashkëta për sfidat me të cilat përballemi. Të gjitha programet dhe aktivitetet e Organizatës (përfshirë - sipas kërkesës - programet e bashkëpunimit me shtetet anëtare dhe jo-anëtare) do të rifokusohen për të përfshirë përbërës që do ta bëjnë kontributin e Organizatës sa më të përshtatshëm, kohor dhe konkret që të jetë e mundur.

³⁹ Shih Deklaratën e GRETA të 3 prillit 2020

⁴⁰ Komiteti i Palëve të Konventës MEDICRIME do të nxjerrë këshilla për zbatimin e Konventës në kontekstin e COVID-19 (<https://www.coe.int/en/web/medicrime/home>)